



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100537/10

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandim për kryerjen e kontrollit të vazhdueshëm shëndetësor të të burgosurit ndaj të cilit është ushtruar forcë fizike (rasti i të dënuarit E. M.)*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Drejtorit të Përgjithshëm

Z. Agim Isamili

Tiranë

**IEVP KORÇË**

Drejtorit

Z. Altin Gusho

*Të nderuar zotërinj,*

Sikurse jeni vënë në dijeni me letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur, në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari E. M., që aktualisht është duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë. Ai pretendon se në datën 27.03.2021 është urdhëruar nga Shefi i Regjimit A. O. që të lëvizë nga një dhomë e sektorit të veçimit në një dhomë tjetër, por ai ka kundërshtuar për arsye se nuk i është dhënë një urdhër me shkrim. Në këto rrethana ai është dhunuar fizikisht nga punonjës të grupit të sigurisë, fillimisht brenda në dhomë ku edhe i është mbyllur goja me bluzë në mënyrë që të mos dëgohen të bërtiturat, e më pas në koridor.

Për verifikimin e kësaj ankese nga ana jonë iu kërkuar<sup>1</sup> Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të na vinte në dispozicion me CD pamje të kamerave të sigurisë së IEVP Korçë, për diapazonin kohor, nga çasti që punonjësit e policisë së IEVP-së kanë shkuar në dhomën e veçimit ku mbahej i dënuari E. M. për ta lëvizur atë në një dhomë tjetër e deri në çastin kur kanë përfunduar veprimet e punonjësve për zbatimin e urdhrit të risistemimit. Gjithashtu, iu drejtuam<sup>2</sup> IEVP Korçë të na informonte nëse kishte patur ndonjë incident ndërmjet të dënuarit E. M. dhe punonjësve të policisë së IEVP-së në datën 27.03.2021 si dhe cilat ishin arsyet e mbajtjes në mjedisin e veçimit të të dënuarit. Po ashtu, kërkuam të na dërgohej fotokopje e dokumentacionit për këtë rast si: urdhri i risistemimit, raport shërbimi për ngjarjen, formularë të përdorimit të forcës nga ana e punonjësve të policisë, fletë të kartelës klinike ku janë lënë shënimet e mjekut lidhur me kontrollin e ushtruar pas përdorimit të forcës dhe të praktikës së masës disiplinore nëse ishte dhënë një e tillë.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën Nr.3801/3 prot., datë 25.05.2021, për sa i përket kërkesë sonë për të administruar pamjet e kamerave të sigurisë thuhet se: “... pajisjet e regjistrimit në IEVP Korçë regjistrojnë filmime në vartësi të aktivitetit që kryhet në IEVP, deri në 10 ditë, në këto kushte nuk mundemi t’ju a vëmë në dispozicion pamjet e kërkuara”.

Në mungesë të pamjeve të kamerave të sigurisë, të cilat do të na mundësonin të verifikonim në mënyrë më të plotë pretendimin e të dënuarit E. M. për sa i përket veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë kur ai është lëvizur me forcë në koridor, në analizën tonë do t’i referohemi vetëm informacionit dhe dokumentacionit që na është dërguar për këtë rast nga IEVP Korçë.

Sipas të dhënave rezulton si më poshtë vijon:

I dënuari E. M. për një periudhë kohore është mbajtur në sektorin e veçimit me kërkesën e tij si dhe duke patur parasysh mos përshtatjen në sektorët ku janë vendosur për banim të dënuar të tjerë. Në datën 23.03.2021, të dënuarit E. M. i është komunikuar nga Shefi i Policisë, Komisar A. B. se ai do të risistemohej në një dhomë tjetër, në bazë të udhëzimeve të dhëna mbi sistemimin e të dënuarve të mbikëqyrjes së veçantë me qëllim garantimin e sigurisë. Me propozimin<sup>3</sup> e Specialistit të Regjimit të Brendshëm e Shefit të Sektorit

<sup>1</sup> Shkresa Nr.K2/E8-3 Prot., datë 08.04.2021.

<sup>2</sup> Shkresa Nr.K2/E8-2 Prot., datë 08.04.2021 dhe K2/E8-6 Prot., datë 29.04.2021.

<sup>3</sup> Shkresa me Nr.823 Prot., datë 24.03.2021 dhe lëndë “Propozim për lëvizje dhe sistemim në dhoma”.

Social dhe me miratimin e Shefit të Policisë si dhe drejtorit të IEVP Korçë, është vendosur që i dënuari E. M. duhet të risistemohet brenda sektorit të veçimit nga një dhomë në një tjetër për arsye se dhomat 1 – 4 do të shërbenin për të mbajtur të dënuar, të cilët do të qëndronin nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë.

Në datën 27.03.2021, Specialisti i Regjimit të Brendshëm A. O. bashkë me punonjësit e grupit të sigurisë, në zbatim të urdhrit të risistemimit, i kanë komunikuar të dënuarit E. M. të zhvendosë sendet personale në dhomën ku ishte caktuar të banonte, por janë ndeshur me kundërshtimin e të dënuarit, i cili është shprehur me fjalët: *“Nuk ka burrë nëne që më lëviz mua”*. Punonjësit e policisë i kanë kërkuar të dënuarit të ruajë qetësinë dhe të zbatojë urdhrin. Sërish i dënuari ka kundërshtuar dhe u është përgjigjur me fjalë fyese duke ofenduar stafin policor. Lidhur me situatën e krijuar është njoftuar Specialisti i Informacionit, i cili gjithashtu ka komunikuar me të dënuarin për ta bindur të zbatojë urdhrin, por pa rezultat, pas i dënuari nuk ka pranuar asnjë marrëveshje. Në këto kushte është njoftuar Shefi i Policisë, i cili ka urdhëruar lëvizjen e të dënuarit në dhomën e caktuar të ambientit të veçimit. Grupi i sigurisë ka prangosur të dënuarin E. M. dhe gjatë shoqërimit për në dhomën e caktuar të banimit janë fyer dhe shkëlmuar prej tij. Punonjësit e policisë që kanë zbatuar urdhrin kanë plotësuar formatin tip mbi përdorimin e forcës ku ndër të tjera shënohet se, është përdorur teknikë për kontrollin fizik me forcë të të dënuarit, atij i janë vendosur prangat, nuk është përdorur shkopi i gomës dhe të dënuarit nuk i janë shkaktuar dëmtime. Për këtë ngjarje është përpiluar Raport Shërbimi (Incidenti) dhe më tej me Urdhrin Nr.224, datë 31.03.2021 është mbledhur Komisioni Disiplinor, i cili në përfundim të procesit disiplinor ka vendosur ndaj të dënuarit E. M. masën “14 ditë përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta”.

Në procesverbalin e datës 31.03.2021, të mbajtur nga kartelisti i IEVP-së, është shënuar se i dënuari E. M. nuk ka pranuar fillimisht të dalë para Këshillit Disiplinor duke u shprehur se *“ju nuk mund të bëni çtë doni me mua...”*. Ndërsa kur është paraqitur para Këshillit Disiplinor, ai nuk ka pranuar të dëgjojë Raportin e Shërbimit duke u larguar. Në Urdhrin Nr. 224, datë 31.03.2021, për fillimin e procedurave disiplinore ndaj të dënuarit E. M. është shënuar se ai refuzon të nënshkruajë, shoqëruar me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli<sup>4</sup>, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore. Ndërsa, Vendimi Nr.224/1, datë 31.03.2021, i dhënies

---

<sup>4</sup> Nënshkrimi është bërë nga Kartelisti dhe Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve Sociale.

së masës disiplinore nuk mban nënshkrimin e të dënuarit se i është dorëzuar një kopje ose shënimin nëse ai ka refuzuar të njihet me masën e dhënë ndaj tij.

Referuar nenit 120, pika 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, njoftimi i të paraburgosurit apo të dënuarit, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.

Ndërsa, pika 5 e nenit 120 parashikon se, komisioni disiplinor i dorëzon të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore, pa përcaktuar nëse duhet të nënshkruhet ose jo nga i interesuari.

Pavarësisht se në legjislacionin në fuqi nuk parashikohet shprehimisht se i burgosuri duhet të nënshkruajë vendimin që i komunikohet dhe në rast refuzimi, vendimi duhet të nënshkruhet nga dy persona të tjerë të personelit me shënimin “refuzon firmën”, çmojmë se kjo procedurë duhet të zbatohet në të gjitha I EVP-të për të mos lënë mundësi që të ngrihen pretendime, qoftë edhe të pabazuara. Nga ana tjetër sjellim në vëmendje faktin se barra e provës për respektimin e procedurës bie mbi institucionin që e ka ndërmarrë atë. Nëpërmjet njohjes me vendimin e marrë, të burgosurit i krijohet mundësia për t'a ankimuar masën disiplinore duke iu garantuar në këtë mënyrë e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Për sa i përket interesimit tonë lidhur me kontrollin shëndetësor të të dënuarit pas përdorimit të forcës, në përgjigjen e marrë nga I EVP Korçë thuhet se: *“bazuar tek informacioni i dhënë nga mjekja e institucionit Dr.N. B. rezulton se në kartelën klinike të të dënuarit E. M. Nr.4237 nuk rezulton vizitë dhe probleme shëndetësore si pasojë e dhunës e verifikuar prej meje Dr. N. B. dhe nga mjeku Dr. Ç. F. datë 27.03.2021”*. Pra, pavarësisht se nuk na janë dërguar fletë të kartelës klinike të të burgosurit E. M. (të kërkuar nga ana jonë në shkresën dërguar I EVP Korçë), nga ky informacion rezulton se gjatë shtrëngimit fizik apo menjëherë pas tij nuk është ushtruar kontroll nga ana e stafit mjekësor e pas ekzaminimit të jenë lënë shënimet përkatëse në kartelën e të dënuarit, qoftë edhe në rastin kur nuk konstatohet asnjë dëmtim apo lëndim fizik tek ai.

Kërkesa jonë për t'ju informuar mbi kontrollin dhe konstatimet e mjekut pas ushtrimit të forcës ndaj të dënuarit E. M. bazohet në legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e lëna nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin osë Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), për të garantuar në këtë mënyrë në çdo rast e për çdo rrëthanë, zbatimin e të drejtave të të burgosurve gjatë ndjekjes së procedurave përkatëse.

Referuar nenit 70, pika 3, të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i burgosuri, pas përdorimit të forcës, duhet t'i nënshtrohet ekzaminimit dhe trajtimit mjekësor. Në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, punonjësi i institucionit, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të burgosurit, duhet menjëherë të vërë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit nëpërmjet një raporti, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, në ç'masë dhe me cilat mjete është ushtruar forca, si dhe nëse ka shkaktuar ose jo lëndime fizike tek i burgosuri ose tek personeli i burgjeve. Ndërsa në pikën 7 të nenit 70 përcaktohet se i burgosuri duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor gjatë shtrëngimit fizik<sup>5</sup>. Po ashtu, në nenin 123, pika 7 të Rregullores së

---

<sup>5</sup> Më konkretisht, në Nenin 70 “Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese” të Ligjit Nr.81/2020, përcaktohet si më poshtë:

1. Përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurit nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur duhet të jetë në minimumin e mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. I burgosuri, pas përdorimit të forcës, duhet t'i nënshtrohet ekzaminimit dhe trajtimit mjekësor. Në të gjitha rastet e përdorimit të forcës, punonjësi i institucionit, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të burgosurit, duhet menjëherë të vërë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit nëpërmjet një raporti, ku jepen arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, në ç'masë dhe me cilat mjete është ushtruar forca, si dhe nëse ka shkaktuar ose jo lëndime fizike tek i burgosuri ose tek personeli i burgjeve.

4. Mjetet e shtrëngimit fizik mund të përdoren për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personelit të institucionit, të burgosurve të tjerë, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të burgosurit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik si mjet ndëshkimi.

5. Personeli, që merret drejtpërdrejt me të burgosurit, trajnohet paraprakisht para se të marrë detyrën për teknikat që bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës.

6. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik kryhet në mënyrë të përshtatshme, në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut dhe duhet të jetë i kufizuar në kohë. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik, për një periudhë më të gjatë se 48 orë, bëhet me miratimin e prokurorit.

7. Gjatë shtrëngimit fizik, i burgosuri duhet të jenë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.

8. Në rastin e të dënuarve të mitur, forca dhe mjetet e shtrëngimit fizik përdoren vetëm në përputhje me rastet e jashtëzakonshme dhe kufijtë e përcaktuar në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Forca dhe mjetet e tjera shtrënguese nuk mund të përdoren në asnjë rast për të miturën shtatzënë, përveç rastit kur ajo ka për qëllim të vetëdëmtohet.

Përgjithshme të Burgjeve<sup>6</sup> parashikohet se, në rast dëmtimi fizik të të burgosurit gjatë ushtrimit të forcës, atij i jepet ndihma e menjëhershme mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se në raportin e bërë publik në datën 17.09.2019, nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin osë Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018<sup>7</sup>, në pjesën që ka të bëjë me IEVP-të, shkronja C, pika 4, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për stafin shëndetësor në lidhje me dokumentimin e dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të dhunës, që sipas CPT-së nuk janë të hollësishme dhe pa përfundime. Në mënyrë të përmbledhur po rendisim rekomandimet e CPT:

Së pari, procesverbali i përpiluar pas ekzaminimit mjekësor të një të burgosuri duhet të përmbajë:

(i) një përmbledhje të plotë të gjetjeve mjekësore objektive të bazuara në këqyrjen fizike (shënimin e dëmtimeve traumatike dhe mundësisht fotografitë e dëmtimeve);

(ii) marrja e deklarimeve të të burgosurit që janë të rëndësishme për ekzaminimin mjekësor;

(iii) mendimin e mjekut në varësi të gjetjeve mjekësore objektive dhe deklarimeve.

---

<sup>6</sup> Neni 123

Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik

1. Ndalohet përdorimi i forcës ndaj të paraburgosurve apo të dënuarve, përveçse si mjet I fundit për vetëmbrojtje apo, në rast se tentohet arratisja, bëhet rezistencë fizike ndaj një urdhri të ligjshëm, ka një rrezik të drejtpërdrejtë për shkaktim dëmi ndaj vetvetes apo i shkaktohet një dëm serioz pasurisë.

2. Shkalla e përdorimit të forcës do të jetë minimumi i nevojshëm dhe zbatohet për kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve harton dhe realizon një plan trajnimi të personelit të institucioneve për teknika që mundësojnë përdorimin minimal të forcës për të ndaluar sjelljet agresive.

4. Ndalohet përdorimi i prangave apo këmishëve të forcës, me përjashtim të rasteve, kur forma të tjera të përdorimit të forcës më pak intensive kanë dështuar. Prangat mund të përdoren nëse janë të domosdoshme për të parandaluar një sjellje të dhunshme ose, nëse gjatë transferimit, i mituri bën përpjekje për t'u arratisur. Prangat hiqen kur i paraburgosuri apo i dënuari shfaqet para një organi gjyqësor apo administrativ, me përjashtim të rastit kur ky autoritet vendos ndryshe.

5. Ndalohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik më gjatë sesa është e nevojshme. Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe hekurave.

6. Izolimi në një dhomë të veçuar si mjet kufizimi i përkohshëm përdoret vetëm përjashtimisht dhe vetëm për pak orë dhe, në çdo rast, nuk duhet të kalojë 24 orë.

7. Në rast të dëmtimit fizik të të paraburgosurit apo të të dënuarit, atij i jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore.

8. Në rastin e tejkalimit të masës së përdorimit të forcës nga ana e punonjësve të IEVP-së, ndaj tyre veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

<sup>7</sup> Për më tepër, shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

Procesverbali gjithashtu duhet të përmbajë rezultatet e ekzaminimeve shtesë të kryera, përfundimeve të hollësishme të mjekut specialist dhe një përshkrim të trajtimit të dhënë për dëmtimet. Rezultatet e secilit prej ekzaminimeve dhe rezultatet e mjekut t'i vihen në dispozicion të dënuarit/të paraburgosurit dhe mbrojtësit të tij ligjor.

Së dyti, sa herë që dëmtimet regjistrohen nga një punonjës i stafit shëndetësor sipas pretendimeve të të dënuarit/ të paraburgosurit për keqtrajtim (ose që, edhe në mungesë të pretendimeve, janë tregues i keqtrajtimit), rasti i raportohet prokurorisë, pavarësisht dëshirës së personit në fjalë. Stafit shëndetësor duhet ta vërë në dijeni të dënuarin/ të paraburgosurin për detyrimin ligjor të mjekut për raportim dhe se ky raportim nuk zëvendëson paraqitjen e një ankese prej vetë të dënuarit/ të paraburgosurit.

Së treti, personeli mjekësor që punon pranë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duhet të ketë në vëmendje detyrimin ligjor që të raportojë, brenda 48 orëve, te prokurori kompetent çdo lëndim/dëmtim që është një tregues i përdorimit të dhunës.

Në përfundim të hetimit administrativ që ndërmorëm për të verifikuar pretendimin e të dënuarit E. M., pavarësisht se nuk mund të provojmë nëse ndaj tij ka patur tejkalim të forcës, kjo edhe për mugesë të pamjeve filmike, nga informacioni i administruar dhe shënimet e mjekut të IEVP Korçë lidhur me rastin objekt ankese, në vlerësimin tonë kontrolli mjekësor nuk është kryer, detyrim që duhet të përmbushej në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të CPT-së. Sipas rekomandimeve, të trajtuara më lart, do të duhej që edhe në këtë rast të ishte përpiluar një procesbebal për ekzaminimin e të dënuarit nga mjeku i IEVP-së, e më pas të bëheshin shënimet respektive në kartelën e të burgosurit, qoftë edhe në rastin kur nuk konstatohet asnjë problem shëndetësor.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave nga punonjësit e stafit shëndetësor të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, për kryerjen e kontrollit të vazhdueshëm shëndetësor të të burgosurit, ndaj të cilit është ushtruar forcë fizike dhe lënien e shënimeve përkatëse në kartelën klinike të tij, qoftë edhe në rastin kur tek ai nuk konstatohet asnjë dëmtim apo lëndim fizik.
2. Marrjen e masave për zbatimin me korrektësi e në zbatim të ligjit të procedurave lidhur me konstatimin e raportimin e përdorimit të forcës gjatë kryerjes së veprimeve me të burgosurit.
3. Përgjithësimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në të gjitha IEVP-të dhe informimin e punonjësve të stafit shëndetësor mbi gjetjet e Raportit të CPT-së dhe rekomandimet në lidhje me dokumentimin e dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të përdorimit të forcës.
4. Marrjen e masave për përmirësimin e procedurës që duhet të ndiqet nga administrata e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sa i përket njohjes së të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij, duke i kërkuar atij të nënshkruajë vendimin e marrë ndaj tij si në kopjen që i dorëzohet ashtu edhe në atë që ruhet në dosjen personale, dhe në rast refuzimi, vendimi të nënshkruhet nga dy persona të tjerë të personelit me shënimin “refuzon firmën”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**